

VENDIM
Nr. 152, datë 30.9.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
DRAFTRREGULLORES “PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT, MODIFIKIMIT,
TRANSFERIMIT TË PJESSHËM OSE TË PLOTË, HEQJEN E LICENCEVE NË
SEKTORIN E GAZIT NATYROR”**

Ne mbështetje të nenit 24, të ligjit nr. 102 /2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të nenit 26, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2016, pasi shqyrtoi relacionin e draftrregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, të përgatitur nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e draftrregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të pjesshëm ose të plotë, heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti